



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:224756

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810697

KPPP.nr. 40/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Regjioni” Sh.A., me numër të biznesit 70433554 dhe me seli në Gjakovë, rr. “UÇL”, nr. 7, kundër debitorit Alfa Plast- P.Sh. me seli në Gjakovë, rr. “Nënë Tereza”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 717/23, i lejuar me datë 29.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datë 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Alfa Plast- P.Sh., ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 717/23, i lejuar me datë 29.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, për borxhin në shumë prej EUR 238.72 dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZHET pjesërisht prapësimi i debitorit Alfa Plast- P.Sh., ashtu që pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 717/23, i lejuar me datë 29.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, sa i përket borxhit në shumë prej EUR 79.60, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Regjioni” Sh.A., mbi bazën e ekstraktit nga librat e kontabilitetit nr. 012120, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 717/23, të datës 29.09.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 318.32, me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në

përmbushjen definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përbarimit me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përbarimor nuk është titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Ka shtuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar konform nenit 360, par. 1, pika 1.1 të LMD-së, ngase ka kërkuar borxhin nga data 01.09.2018 deri me datë 01.09.2023. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, e sipas nenit 29, par. 1 të LPP-së, konsiderohet si dokument i besueshëm më të cilin mund të kërkohet përbarimi. Ndërsa, sa i përket pretendimeve për parashkrim, të njëjtat janë të pa bazuara për faktin se duke qenë se debitori hyn në kategorinë e konsumatorëve komercial, kërkesat nga kontratat komerciale parashkruhen për tri vite, sipas nenit 355 të LMD-së. Ka shtuar se edhe sipas nenit 368 të LMD-së, pranimi i borxhit nënkupton ndërprerje të parashkrimit, e i cili është bërë me deklarin e vullnetit të debitorit që është i mjaftueshëm për të manifestuar pranimin e borxhit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke ju referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.2 e të njëjtit nen përcakton ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokumente të besueshme sipas së cilave mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përbarim*

paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht ekstraktin e verifikuar nga librat afarist me shifër nr. L0214513, i cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, meqenëse në ekstrakt janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitorit, janë përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Ndërsa, pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit lidhur me afatin e parashkrimit, gjykata ka shqyrtuar ekstraktin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në raport me faturat e përfshira ekstrakt dhe në mbështetje të dispozitave nga 355 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Sipas nenit 355.1 të LMD-së, *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.* Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat e përfshira në ekstrakt nga data 01.09.2018 deri me datën 29.09.2020 në shumën prej EUR 238.72 kanë arritur afatin e parashkrimit, ngase propozimi për përmbarim nga ana e kreditorit në raport me këto fatura është paraqitur me datë 29.09.2023, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes për pagesë.

Ndërsa sa i përket borxhit për periudhën kohore 29.09.2020 e deri me datë 29.09.2023, në shumën prej EUR 79.60 gjykata gjeti se nuk janë përfshi në parashkrim për arsye se për këtë pjesë të borxhit, propozimi për përmbarim është paraqitur brenda periudhës tre (3) vjeçare nga dita kur secila kërkesë është bërë e arritshme.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12.2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i*

anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit, duke përfunduar procedurën përmbartimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 238.72.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 40/24, datë 11.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.